



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istok Municipality

05.Nr.ref.400/26

Datë: 10.07.2026

Duke u bazuar në nenet 78 ,80, 81 dhe 82 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenin 5 të Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenin 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës, UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-MASHT, Nr.01/2022 për Ndryshim dhe Plotësim të UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-MASHT, Nr.05/2015 për Normativin për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional neneve 8, 10 dhe 20 të Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar si dhe Rregullores (QRK) Nr.27/2024 për procedurat Konkurruese dhe Pranimit për Nënpunësit Administrativ dhe Mbështetëse, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall:

KONKURS

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesua

Nr.	Institucioni	Titulli i vendit të punës	Vend i lirë/zëvendësim	Numri i pozitive	Koeficienti i pagës	Norma
1.	SHFMU "Bajram Curri" Istog paralelja e ndarë Dubravë	Mësimdhënës/e i/e Mësimi klasor	Zëvendësim	1	E19 -6.6	20 orë
2.	SHFMU "Hysni Zajmi" Vrellë Paralelja e ndarë Studenicë	Mësimdhënës/e i/e Mësimi klasor	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	20 orë
3.	SHFMU "Avni Rrustemi" Zallq	Mësimdhënës/e i/e Mësimi klasor	Vendi i lirë për një vite deri me 31.08.2027	1	E19 -6.6	20 orë
4.	SHFMU "Bajram Curri" Istog	Mësimdhënës/e i/e Mësimi klasor	Zëvendësim	1	E19 -6.	20 orë
5.	SHFMU "Fan S.Noli" në Llukac të Begut	Mësimdhënës/e i/e Mësimi klasor	Zëvendësim deri në përfundim të mandatit të drejtoreshës	1	E19 -6.6	20 orë
6.	SHFMU "Fan S.Noli" në Llukac të Begut	Mësimdhënës/e i/e Mësimi klasor	Zëvendësim	1	E19 -6.6	20 orë
7.	SHFMU "Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe" Uçë	Mësimdhënës/e i/e Mësimi klasor	Zëvendësim	1	E19 -6.6	20 orë
8.	SHFMU "Hysni Zajmi" Vrellë	Mësimdhënës/e i/e Gjuhës Shqipe	Zëvendësim	1	E19 -6.6	20 orë
9	SHFMU "Trepça" Banjë	Mësimdhënës/e i/e Gjuhës Shqipe	Zëvendësim	1	E19 -6.6	19 orë

10	SHFMU "Martin Camaj" Gurrakoc	Mësimdhënës/e i/e Gjuhë Angleze	Zëvendësim	1	E19 -6.6	20 orë
11.	IAAP "Mithat Frasheri" Gurrakoc paralelja e ndarë në Rudina " Burgu i Dubravës	Mësimdhënës/e i/e Gjuhë Angleze	Vend i lirë	1	E.17-6.8	12 orë
12	SHFMU "Fan S.Noli" në Llukac të Begut me plotësim norme në IP "Gëzimi Ynë" në Istog	Mësimdhënës/e i/e Gjuhë Angleze	Zëvendësim deri në kthim të mësimdhënës nga pozita e pezulluar.	1	E19 -6.6	19 orë
13	SHFMU "Martin Camaj" Gurrakoc me plotësim norme ne SHFMU "Bajram Curri" Istog	Mësimdhënës/e i/e Gjuhës Gjermane	Vend i lirë	1	E19 -6.6	18 orë
14	SHFMU "Hysni Zajmi" Vrellë SHFMU "Zymer Zeka" Kaliqan SHFMU "Fan S.Noli" në Llukac të Begut.	Mësimdhënës/e i/e Gjuhës Gjermane	Vend i lirë	1	E19 -6.6	19 orë
15	SHFMU "Ndre Mjeda" Rakosh me plotësim norme në "Tre Dëshmoret" Uçë, "Mehmet Akifi" Shushicë dhe SHFMU "Avni Rustemi" Zallq	Mësimdhënës/e i/e Gjuhës Gjermane	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	18 orë
16	IAAP "Mithat Frasheri" Gurrakoc me plotësim norme në SHFMU "Ismail Qemali" Saradran	Mësimdhënës/e i/e Gjuhë Gjermane	Vend i lirë	1	E.17-6.8	15 orë
17	Gjimnazi "Haxhi Zeka" Istog	Mësimdhënës/e i/e Gjuhës Gjermane	Vendi i lirë	1	E.17-6.8	20 orë
18	SHFMU "Bajram Curri" Istog	Mësimdhënës/e i/e Artit Muzikor	Zëvendësim	1	E19 -6.6	20 orë
19	SHFMU "Hysni Zajmi" Vrellë	Mësimdhënës/e i/e Matematikës	Zëvendësim deri sa të kthehet mësimdhënësi nga pushimi mjekësor	1	E19 -6.6	20 orë
20	SHFMU "Fan S.Noli" Llukac i Begut me plotësim norme në "Ismail Qemali" Saradran	Mësimdhënës/e i/e Matematikës	Vend i lirë	1	E.17-6.8	20 orë
21	SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh	Mësimdhënës/e i/e Matematikës	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	20 orë
22	SHFMU "Mehmet Akif" Shushicë me plotësim norme në SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh	Mësimdhënës/e i/e Matematikës	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	20 orë
23	Gjimnazi "Haxhi Zeka" Istog	Mësimdhënës/e i/e Matematikës Mësim Zgjedhor	Kontratë punë një vjeçare deri me 31.08.2027	1	E.17-6.8	20 orë

24	IAAP "Mithat Frasheri" Gurrakoc paralelja e ndarë në Rudina " Burgu i Dubravës	Mësimdhënës/e i/e Matematikës	Vendi i lirë	1	E.17-6.8	12 orë
25	SHFMU "Avni Rustemi" Zallq me plotësim norme në "Fan S.Noli" Llukac dhe SHFMU "Hysni Zajm" Vrellë	Mësimdhënës/e i/e Fizikës	Vendi i lirë	1	E19 -6.1	18 orë
26	SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh me plotësim norme ne SHFMU "Zymer Zeka" Kaligan	Mësimdhënës/e i/e Fizikës	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	20 orë
27	SHFMU "Hysni Zajmi" Vrellë me plotësim norme ne IAAP "Mithat Frasheri" Gurrakoc	Mësimdhënës/e i/e Kimisë	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	17 orë
28	SHFMU "Bajram Curri" Istog me plotësim norme ne SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh	Mësimdhënës/e i/e Biologjisë	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	16 orë
29	SHFMU "Fan S.Noli" Llukac p.n SHFMU "Mehmet Akif" Shushicë dhe SHFMU "Bajram Curri" Istog	Mësimdhënës/e i/e Gjeografisë	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	19 orë
30	SHFMU "Ndre Mjeda" Rakosh me plotësim norme në SHFMU "Tre Dëshmoret" Uçë	Mësimdhënës/e i/e Gjeografisë	Zëvendësim deri sa të kthehet mësimdhënësi nga pushimi mjekësor	1	E19 -6.6	17 orë
31	SHFMU "Ismail Qemali" Saradran	Mësimdhënës/e i/e TIK-ut	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	10 orë
32	Gjimnazi "Haxhi Zeka" Istog	Mësimdhënës/e i/e Ekonomisë Mësim Zgjedhor	Kontratë punë një vjeçare deri me 31.08.2027	1	E.17-6.8	20 orë
33	IAAP "Mithat Frasheri" Gurrakoc	Mësimdhënës/e i/e Lendeve Mjekësore (Specialist i Mjekësisë) Mjeke i Përgjithshëm	Vendi i lirë	1	E.17-6.8	11 orë
34	IAAP "Mithat Frasheri" Gurrakoc	Mësimdhënës/e i/e Makinërisë	Me kandidatin e pranuar do të lidhet kontratë pune nëse formohen paralelet	1	E.17-6.8	19 orë
35	IAAP "Mithat Frasheri" Gurrakoc	Mësimdhënës/e i/e Elektroteknikës	Me kandidatin e pranuar do të lidhet kontratë pune nëse formohen paralelet	1	E.17-6.8	20 orë

36	IAAP "Mithat Frasheri" Gurrakoc	Mësimdhënës/e i/e Elektroteknikes	Vendi i lirë	1	E.17-6.8	16 orë
37	SHFMU "Trepça" Banjë me plotësim norme në "Fan S.Noli" Llukac	Mësimdhënës/e i/e Gjeografisë për nxënësit e komunitetit boshnjak	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	14 orë
38	SHFMU "Fan S.Noli" Llukac i Begut me plotësim norme në "Trepça" Banjë	Mësimdhënës/e i/e Fizikës për nxënësit e komunitetit boshnjak	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	16 orë
39	SHFMU "Trepça" Banjë t me plotësim norme në "Fan S.Noli" Llukac i Begu	Mësimdhënës/e i/e Kimisë për nxënësit e komunitetit boshnjak	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	12 orë
40	SHFMU "Fan S.Noli" Llukac i Begut me plotësim norme në "Trepça" Banjë	Mësimdhënës/e i/e Biologjisë për nxënësit e komunitetit boshnjak	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	16 orë
41	SHFMU "Fan S.Noli" Llukac i Begut me plotësim norme në "Trepça" Banjë	Mësimdhënës/e i/e Historisë për nxënësit e komunitetit boshnjak	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	16 orë
42	SHFMU "Fan S.Noli" Llukac i Begut me plotësim norme në "Trepça" Banjë	Mësimdhënës/e i/e TIK- ut për nxënësit e komunitetit boshnjak	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	16 orë
43	SHFMU "Trepça" Banjë	Mësimdhënës/e i/e Gjuhë Angleze për nxënësit e komunitetit boshnjak	Vendi i lirë	1	E19 -6.6	20 orë
44	Në Institucionet edukativo- arsimore kudo që paraqitet nevoja	Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta	Vende të lira	9	E.22- 6	40 orë
45	IP "Gëzimi Ynë" Istog	Edukatore mbështetëse 0-3	Vendi i lirë	1	E.21-6.1	E plotë 40 orë
46	IP "Gëzimi Ynë" Istog	Edukatore 3-6	Vendi i lirë	2	E.21-6.1	E plotë 40 orë
47	IP "Shpresa Jonë" Banjë	Edukatore 3-6	Zëvendësim i pushimit të lehorisë	1	E.21-6.1	E plotë 40 orë
48	IP "Lulet e Jetës" Vrellë	Edukatore 3-6	Vendi i lirë	1	E.21-6.1	E plotë 40 orë
49	SHFMU "Bajram Curri" Istog	Mirëmbajtës/e	Vende të lirë	1	GJ.51-4.76	E plotë 40 orë
50	SHFMU "Fan S.Noli" Llukac i Begut	Mirëmbajtës/e	Vende të lirë	1	GJ.51-4.76	E plotë 40 orë

I. Kriteret e përgjithshme formale;

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i/e aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Periudha provuese zgjatë 6 muaj;

II.Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës;

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit, Udhëzimin Administrativ, MASHTI, Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-MASHT, Nr.05/2015 për Normativin për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional.

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e Gjuhë Shqipe kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e gjuhës angleze kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Niveli master arsimor Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e Gjuhës Gjermane kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e Matematikës kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e Fizikës kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën mësimdhënës/e i/c Kimisë kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e Gjeografisë kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e Tlk-ut kërkohet kualifikimi si me poshtë:

1.Programi/dega teknologji-informatikë

- Niveli master arsimor-Fakulteti i edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

2.Programi/dega matematikë-informatikë

- Niveli master arsimor-Fakulteti i edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e Histori kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Niveli master arsimor (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e Biologji kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Niveli master arsimor-Fakulteti i edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën Edukatë Figurative kërkohet kualifikimi si me poshtë:

Programi-Pikturë

- Niveli master arsimor- (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Programi-skulpturë:

- Niveli master arsimor- (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Programi grafikë:

- Niveli master arsimor- (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e lëndës së makinerisë kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- MSc. i makinerisë
- Inxh i dipl. i makinerisë;

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e lëndës të mjekësisë kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Specialist i mjekësisë së përgjithshme
- Mjek i përgjithshëm;

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e lëndës të ekonomisë kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- MSc. i ekonomisë
- Ekonomist i diplomuar banka, financa dhe kontabilitet
- Ekonomist i diplomuar i përgjithshëm

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e lëndës së elektroteknikës kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- MSc. i elektroteknikës
- Inxh i dipl. i elektroteknikës-elektronikës;

Për pozitën Mësimdhënës/e i/e mësimi klasor kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Fakulteti i edukimit-programi fillor
- Fakulteti i Mësuesisë

Për pozitën Edukator/c për parafillor kërkohet kualifikimi si me poshtë:

- Fakulteti i edukimit-programi katërvjeçar i nivelit baçelor për edukimin parashkollor;
- Shkolla e Lartë Pedagogjike-drejtimi edukatore;
- Fakulteti filozofik-dega e pedagogjisë së përgjithshme si dhe
- Programi i Përkujdesjes dhe Mirëqenie e Fëmijëve

Për pozitën Edukator/e Mbështetës/e grup mosha (0-3) kërkohet kualifikimi si me poshtë:

1. Fakulteti i edukimit-programi katërvjeçar i nivelit баçelor për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-3 vjeç;
2. Shkolla e mesme e mjekësisë-drejtimi i infermierë edukatore;
3. Shkolla e mesme e mjekësisë-drejtimi i pediatriisë;
4. Shkolla e mesme e mjekësisë-drejtimi mami;
5. Shkolla e mesme e mjekësisë së përgjithshme.

Për pozitën Asistent për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta kërkohet kualifikimi si me poshtë:

Niveli 5-të (post-sekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Kualifikimi i kërkuar për pozitën e shpallur:

Për vendet e punës punëtor/e teknik (pastrues) është obligative që kandidatët ta kenë të përfunduar shkollën e Mesme të Lartë.

III. Detyrat e punës së mësimdhënësve

1. I/e punësuari është i obliguar të realizojë detyrat e punës si ne vijim:

Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj/të punës.

2. Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.

3. Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.

4. Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon.

5. Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

6. Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së.

7. Të mos e shfrytëzoj pozitën e punës për interesa private në dobi të ndonjë pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij.

8. Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhën me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave sipas kësaj kontrate apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.

9. Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.

10. I punësuari është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.

11. I punësuari sipas kësaj kontrate, nuk do të kryejë punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit të saj.

12. Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

IV. Detyrat dhe përgjegjësit e edukatores.

1. Edukatori/ja është përgjegjës/e për sigurimin e kualitetit të lartë të kujdesit dhe edukimit parashkollor përmes punës së drejtpërdrejtë të saj/tij me fëmijët në grupin e saj/tij.
2. Ajo/ai duhet të organizojë programin edukativ që respekton filozofinë dhe konceptin e punës së institucionit ku secili fëmijë individualisht i ofron mbështetjen e nevojshme për zhvillim të plotë, në përgatitjen për shkollimin formal.
3. Për më shumë, ajo/ai duhet të reflektojë në kontributin pozitiv si anëtar i institucionit përmes frymës bashkëpunuese.
4. Përgjegjës për zhvillim të përgjithshëm dhe përkujdesjes për fëmijët sipas standardeve të përcaktuara për edukim.
5. Zbatimi planifikimit vjetor, mujor, javor dhe reflektimit ditor të aktiviteteve sipas grupmohave të fëmijëve.
6. Përgjegjësi për mirëqenien dhe sigurinë e të gjithë fëmijëve në grup përkatës.
7. Vëzhgimin e zhvillimit të secilit fëmijë dhe prezantimin e këtij zhvillimi përmes formave të vëzhgimit
8. Përgjegjëse për mirëmbajtjen e një ambienti edukativ, mikpritës për fëmijë dhe prindër si dhe të mësuarit dhe lojës si dhe pastërtia dhe mirëmbajtja e dhomave të grupeve janë përgjegjësi e edukatorëve.
9. Raportimi i çfarëdo shqetësimi për zhvillimin apo shëndetin e cilit do fëmijë individualisht drejtorit të kopshtit.
10. Ndërtimi i raporteve dhe komunikimit profesional miqësor dhe bashkëpunues me prindër, kolegë dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.
11. Organizimi i takimeve individuale dhe grupore me prindër në nivel grupi.
12. Raportimi i rregullt i dëmeve të evidentuara apo shqetësimeve tjera tek drejtorit i institucionit apo personit përgjegjës.
13. Mbështet dhe ndihmon fëmijët në kapërcimin e gjendjeve emocionale negative si mërzia, agresiviteti, irltim, mlllef, duke i ndihmuar të gjejnë fjalët dhe mënyrat e duhura për të zgjidhur problemin.
14. Nxiti dhe edukon sjellje sociale pozitive midis fëmijëve ku përfshihen bashkëveprimi, respektimi i radhës në lojë dhe zgjidhja e problemeve nëpërmjet fjalës dhe bisedës.
15. Ndhmon fëmijët me nevoja të veçanta të bashkë- veprojnë më fëmijët tjerë, sipas nevojave të tyre.

V. Detyrat dhe përgjegjësit e edukatores mbështetëse

1. Edukatori/ja është përgjegjës/e për sigurimin e kualitetit të lartë të kujdesit dhe edukimit parashkollor përmes punës së drejtpërdrejtë të saj/tij me fëmijët në grupin e saj/tij.
2. Ajo/ai duhet të organizojë programin edukativ që respekton filozofinë dhe konceptin e punës së institucionit ku secili fëmijë individualisht i ofron mbështetjen e nevojshme për zhvillim të plotë, në përgatitjen për shkollimin formal.
3. Për më shumë, ajo/ai duhet të reflektojë në kontributin pozitiv si anëtar i institucionit përmes frymës bashkëpunuese.
4. Përgjegjës për zhvillim të përgjithshëm dhe përkujdesjes për fëmijët sipas standardeve të përcaktuara për edukim.

5. Zbatimi planifikimit vjetor, mujor, javor dhe reflektimit ditor të aktiviteteve sipas grupmohave të fëmijëve.
6. Përgjegjësi për mirëqenien dhe sigurinë e të gjithë fëmijëve në grup përkatës.
7. Vëzhgimin e zhvillimit të secilit fëmijë dhe prezantimin e këtij zhvillimi përmes formave të vëzhgimit
8. Përgjegjëse për mirëmbajtjen e një ambienti edukativ, mikpritës për fëmijë dhe prindër si dhe të mësuarit dhe lojës si dhe pastërtia dhe mirëmbajtja e dhomave të grupeve janë përgjegjësi e edukatorëve.
9. Raportimi i çfarëdo shqetësimi për zhvillimin apo shëndetin e cilit do fëmijë individualisht drejtorit të kopshtit.
10. Ndërtimi i raporteve dhe komunikimit profesional miqësor dhe bashkëpunues me prindër, kolegë dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.
11. Organizimi i takimeve individuale dhe grupe me prindër në nivel grupi.
12. Raportimi i rregullt i dëmeve të evidentuara apo shqetësimeve tjera tek drejtorit i institucionit apo personit përgjegjës.
13. Mbështet dhe ndihmon fëmijët në kapërcimin e gjendjeve emocionale negative si mërzia, agresiviteti, irlitimi, mllëfi, duke i ndihmuar të gjejnë fjalët dhe mënyrat e duhura për të zgjidhur problemin.
14. Nxiti dhe edukon sjellje sociale pozitive midis fëmijëve ku përfshihen bashkëveprimi, respektimi i radhës në lojë dhe zgjidhja e problemeve nëpërmjet fjalës dhe bisedës.
15. Ndihmon fëmijët me nevoja të veçanta të bashkë-veprojnë me fëmijët tjerë, sipas nevojave të tyre.

VI. Detyrat e punës së asistentes

1. Ndihmon në promovimin e arsimit gjithëpërfshirës.
2. Mbështet zhvillimin e gjithmbarshëm të fëmijës/nxënësit, përkujdeset për sigurinë dhe mirëqenien dhe ndihmon në shkathtësitë e jetës së përditshme.
3. Zbaton programin dhe aktivitetet tjera me udhëzime nga mësuesi.
4. Ndihmon dhe mbikëqyrë fëmijën/nxënësin në mësim dhe aktivitete të përcaktuara bashkërisht me mësuesen/in.
5. Merr pjesë në hartimin, zbatimin dhe rishikimin e Planit Individual të Arsimit (PIA) në kuadër të përgjegjësi.
6. Përgatit materiale specifike dhe burime në bashkëpunim me mësuesin.
7. Ndihmon fëmijët /nxënësit në aspektin e komunikimit social, emocional dhe edukativo-arsimor.
8. Ndihmon fëmijët/nxënësit në zhvillim dhe pavarësim, orientim, mobilitet dhe përshtatjen e mjedisit në klasë dhe specifika tjera.
9. Ndihmon fëmijët/nxënësit në nevoja fizike, fiziologjike dhe nevoja tjera.
10. Informon prindërit/kujdestarët e fëmijës dhe personelin në aspektin specifik.
11. Ndihmon nxënësin në përdorimin e pajisjeve ndihmëse teknologjike.
12. Planifikon bashkë me mësuesin për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore.
13. Përcjell punën, evidenton dhe raporton për arritjet e fëmijës/nxënësit tek mësuesja e klasës, kujdestari dhe mësuesit mbështetës çdo tre muaj gjatë vitit shkollor për përparimin (rezultatet) e fëmijës.
14. Respekton etikën, parimet, standardet, rregulloret, konventat për të drejtat dhe ligjet në fuqi.
15. Kujdeset për mirëqenien dhe sigurinë personale të tij/saj, dhe u përmbahet parimeve të organizimit të brendshëm.
16. Kujdeset për ndërveprimin ndërmjet nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe nxënësve tjerë në klasë.
17. Bashkëpunon me profesionistë brenda dhe jashtë shkollës.

18. Bashkëpunon me shërbimet mbështetëse në Qendra burimore.
19. Bashkëpunon me OJQ e specializuara për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.
20. Kujdeset për ruajtjen e informatave konfidenciale për nxënësin.
21. Përcjell nxënësit në aktivitete jashtë kurrikulare me klasë.
22. Pranon dhe përcjell nxënësin te prindi/kujdestari/ transporti, brenda hapësirës së institucionit.
23. Kujdeset për mirëmbajtjen e portfolios/ dosjeve të fëmijëve/nxënësve.
24. Me ftesë të Ekipit Vlerësues Komunal, jep informata të nevojshme për fëmijën/nxënësin e caktuar.
25. Jep informata për punën me FNVA (fëmijën, prindin, mësimdhënësit)
26. Prania e asistentit në klasë nuk e përjashton mësimdhënësin nga detyrimi për të siguruar mësimdhënie për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore.
27. Kur një nxënës lëviz me karrocë nga një pozicion në tjetër, ai mund të mbështetet edhe nga një asistent/c tjetër në shkollë gjatë aktiviteteve jashtë klasës.
28. Asistentët për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore nuk duhet të jenë anëtar i familjes prind/kujdestar ose anëtar tjetër i familjes së afërt të nxënësit/të cilin e mbështetet ai/ajo

VII. Detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorëve shërbyes teknik-pastruesit

Personeli shërbyes-teknik ka për detyrë të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë që janë përcaktuar në kontratën e punës, në këtë rregullore dhe detyra të tjera që ua jep nga drejtori i shkollës.

Të pastrojnë dhe të mirëmbajnë të gjitha ambientet e shkollës, të mirëmbajnë dhe të pastrojnë oborrin dhe lulishten e shkollës;

Një herë në javë të pastroj me detergjente të objektin e shkollës, përkatësisht xhamat e dritareve, dyer, muret, dyshmetë e klasave, të korridoreve, tualetet, zyrat, sallën e mësimdhënësve, sallën e kulturës fizike, laboratorët, kabinetet dhe bibliotekën e shkollës etj.;

Mirëmbajtësit e higjienës kanë për detyrë të identifikojnë, të evidentojnë, të llogaritin dhe të planifikojnë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen nga amortizimi ose harxhimi i mjeteve të punës të nevojshme për mbajtjen e higjienës dhe, sipas nevojës, t'ia prezantojnë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor.

Të ushtrojnë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës, përfshirë ruajtjen e pajisjeve të punës, kujdesin për hapësirën dhe mjetet e punës në lidhje me mënyrat e përdorimit të tyre, ruajtjen e sasisë dhe mos keqpërdorimit të asnjë mjeti, pajisjeve apo objekteve të punës me të cilat punon;

Punëtori teknik ka për detyrë të kujdeset për ngrohjen në shkollë, si ai në shkollat që kanë kalldaja, si në shkollat që ngrohen me stufa me dru, palët, naftë apo thëngjill;

Të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e tij të punës, të parapara me këtë rregullore, me kontratën e punës, si dhe të kryejë të gjitha punët që ia jep drejtori i shkollës.

Punëtorët që përbëjnë personelin teknik në shkollë janë të obliguar të bartin uniformën përkatëse gjatë orarit të punës.

Kujdeset për mirëmbajtjen e inventarit të shkollës;

Përgjigjet për dëmtimet eventuale që bëhen në shkollë e që janë të lidhura me punën dhe detyrat e tij;

Kujdeset për ambientin e jashtëm të shkollës;

Detyrat e punës për stafin teknik përcaktohen nga drejtori i shkollës;

Ndalohet hapja e shkollave nga punëtorët teknik ditëve të pushimit pa lejen e drejtorit të shkollës.

Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e realiteteve të arriturave gjatë orarit zyrtar të punës.

Kryen edhe detyra të tjera që i cakton drejtori i shkollës.

VIII. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim;

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportes),
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Kopja e diplomës ose certifikata në vend të diplomës jo me e vjetër se gjashtë muaj, çdo certifikatë me e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHIT (nëse ka)
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje
- Vërtetimin e përvojës së punës në mësimdhënie, nëse aplikuesi ka përvojë pune
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre.

IX. Kriteret për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.

Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, bëhet sipas kriterëve të mëposhtme;

1. Testi me shkrim;

2. Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios.

2.1. Testi përmbya njëqind (100) pike që përbën 50% të peshës së vlerësimit të përgjithshëm të kandidatit/es

2.2. Komisioni përzgjedhës fiton në testin me gojë/intervistë, pjesëmarrësit e testimit me shkrim të cilët kanë fituar 50% e më shumë të pikëve të testit me shkrim;

2.3. Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm.

2.5. Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai/ajo që i ka fituar së paku 70% të pikëve totale të vlerësimit të kombinuara nga testi me shkrim dhe testi me gojë/intervista

2.6. Renditja e kandidatëve në listën e kandidatëve fitues bëhet sipas pikëve të fituara në listën e rezultateve përfundimtare

2.7. Angazhimi i mësimdhënësve nga lista e kandidatëve fitues (pritëse) mund të bëhet deri në një (1) vit nga publikimi i saj.

Sqarim:

1. Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës

2. Kontratat e punës për stafin e pranuar sipas këtij konkursi do të lidhen atëherë kur pozita e punës lirohet nga i pensionuari apo kur mësimdhënëset shkojnë në pushim të lehonisë apo mjekësor.

Sqarim- në mungesë të kandidatëve të kualifikuar të specifikuar si më lartë në shprehje do të vijnë kandidatët me kualifikim adekuat 180 ECTS të cilët do të pranohen për një vit shkollor, e në rast të mungesës edhe të kandidatëve me 180 ECTS atëherë në konsideratë do të vijnë kandidatët e profileve (drejtimeve) të përafërta të cilët do të pranohen për një vit shkollor, e në rast të mungesës së dy kategorive të fundit në konsideratë do të vijnë studentët e profileve adekuate.

Për pozitat e shpallura për mësimdhënës të cilët do të mbajnë mësim me nxënësit e komunitetit boshnjak preferohet njohja e gjuhës përkatëse.

X. Afati i aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga data 13.07.2026 e deri më datë 11.08.2026 nga ora 08-16

XI. Formulari i aplikimit merret në Zyrën për Shërbim me Qytetar i nijeti duhet të plotësohet të nënshkruhet dhe së bashku me dokumentet e tjera përcjellëse të dorëzohet në Zyrën për Shërbim me Qytetar në Komunën e Istogut.

Pas secilit vlerësim kandidatët pjesëmarrës në konkurs do të njoftohen për rezultatet e tyre për mes emailit dhe ueb-faqes së Komunës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë me konkurs nuk pranohen ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Drejtori i DKA-së
Naim Behlulaj

